



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE DHE NDRIÇIMIT PUBLIK

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM
NË MARRËVESHJEN KUADËR

09.04.2021

Për: *Operatorin Ekonomik "Fusha" sh.p.k, me adresë: rruga "Murat Toptani",
përballë Kinema Milenium, godina nr.3, Pedonalja, Tiranë.*

* * *

Procedura e prokurimit: Kërkesë për propozim

Numri i referencës së procedurës: REF-90277-03-17-2021

Përshkrim i shkurtër i kontratës: "Shpenzime për mirëmbajtjen e objekteve specifike",
Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara,
me afat 12 muaj dhe me fond limit 4.159.583 (katër milion e njëqind e pesëdhjetë e
nëntë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e tre) lekë pa TVSH.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike Nr.42, datë
23.03.2021

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: ☐ oferta ekonomikisht më e favorshme ☒ çmimi
më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me vlerat
përkatëse të ofruara:

1.Operatori Ekonomik "Fusha" sh.p.k, me NUIS J61922018S me vlerë 3.975.850
(tre milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e pesëdhjetë) lekë pa tvsh.

2.Operatori Ekonomik "MENI" sh.p.k, me NUIS J61909018W me vlerë 4.075.700
(katër milion e shtatëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind) lekë pa tvsh.

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1.Operatori Ekonomik "MENI" sh.p.k, me NUIS J61909018W.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1.Operatori ekonomik "MENI" sh.p.k nuk përmbush pikën 1, gërma a) të kriterëve të
veçanta të kualifikimit ku është parashikuar se: **"1. Ofertuesi duhet të dorëzojë: a.
Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës I"**.

Nga shqyrtimi që Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i ka bërë formularit të ofertës të ngarkuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik pjesëmarrës “MENI” sh.p.k rezulton se është ndryshuar sasia për zërin “Vaj termik”. Në shtojcën 10 të dokumentave standarte të tenderit, nga ana e Autoritetit Kontraktor është kërkuar një sasi prej 2.000 litrash për zërin “Vaj termik” ndërsa në ofertën e paraqitur nga operatori rezulton sasia 2.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave arsyeton se në Seksionin 1 të Dokumentave Standarde të Tenderit "Hartimi i ofertes" parashikohet se "1.Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme."

Në nenin 53, pika 1 të ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikohet se “1.Autoriteti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në nenet 32 dhe 33 të këtij ligji, nuk duhet të kërkohej, ofrohet apo **lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës**, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.”

Referuar sa më lart, ndodhur para kushteve ku kemi të bëjmë me ndryshim të sasisë për zërin “Vaj termik” oferta e operatorit ekonomik pjesëmarrës “MENI” sh.p.k konsiderohet e pavlefshme dhe rrjedhimisht refuzohet si e papranueshme.

2. Operatori ekonomik “MENI” sh.p.k nuk përmbush pikën 2.3.11 për kapacitetin teknik ku është parashikuar se: ”Për të provuar përmbushjen e kapaciteteve të mëposhtme, Ofertuesi duhet të dorëzojë:Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës.

Mjetet	Sasia	Gjendja
<i>Autovinç me kapacitet mbajtës mbi 10 ton</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Autokullë për punime në lartësi</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Platformë lëvizëse teleskopike</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Motosaldatriçe me elektrogjen</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Kompresor, gjenerator</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Matrapik</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>

- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme). Per mjetet e marra me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit,(te vlefshme) duhet te shoqerohet me kontraten perkatese te qerase, e

vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

- b)** Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.*
- c)** Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku për mjetet e targuara të jetë e dukshme dhe targa e tij.*
- d)** Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).*

Nga verifikimi që Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i ka bërë dokumentacionit të ngarkuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik rezulton se operatori nuk ka paraqitur dokumentacion për mjetin “Autokullë për punime në lartësi” në kundërshtim me parashikimin e mësipërm.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1.Operatori Ekonomik “Fusha” sh.p.k, me NUIS J61922018S me vlerë 3.975.850 (tre milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e pesëdhjetë) lekë pa tvsh.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, me adresë: rruga “5 Maji”, Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 01.04.2021

Ankesa: Nuk ka

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Herion Rrapaj